

**AKT THEMELIMI
SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MONTIS Travel & Tours”**

Sot në Tiranë, më 30.05.2024, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar “**MONTIS Travel & Tours**”.

Unë ortaku i vetëm Entela SHEHAJ, i datëlindjes 12.08.1970, e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal H05812051G, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

THEMELIMI

Neni 1

Themelohet Shoqëria tregtare “MONTIS Travel & Tours”, e cila do të nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare “MONTIS Travel & Tours” do të jetë në adresën: **Rruga “Robert Shvarc”, Ndërtesa Nr. 5, Kati 1, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë.**

Neni 3

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar me objekt:

Organizimi i udhëtimeve turistike individuale dhe me grupe brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë transportin, akomodimin, ushqimin, vizita në muze, vende turistike ose historike, shfaqje teatrale, muzikore ose sportive, si edhe përgatitjen e dokumentacioneve të udhëtimit dhe vizat. Organizim eskursionesh dhe udhëtime pune sipas kërkesave të shoqërive tregtare, shoqatave apo institucioneve publike dhe private. Shitje dhe blerje biletash, të paketave turistike për evente sportive apo aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike. Shoqëria do të kryejë aktivitet në fushën e promovimit të turizmit vendas e të huaj në bashkëpunim me agjenci, persona fizikë e juridikë, individë dhe institucione të ndryshme shtetërore publike e private.

Shitje dhe blerje biletash avioni, trageti, autobusi si dhe të mjeteve të ndryshme në fushën e turizmit, hotelerisë dhe të rezervimeve në platformat online.

Neni 5

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes të mbarrëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100,000 (Njëqind mijë lekë)**, kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Entela Shehaj zotërues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 Lek që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.



KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "MONTIS Travel & Tours" do të drejtohet nga Administratori i saj Zj. Entela SHEHAJ për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

Neni 10

Shoqëria tregtare "MONTIS Travel & Tours" do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria tregtare "MONTIS Travel & Tours" deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjisllacionit shqiptar në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në gjuhën shqipe dhe miratohet prej ortakut të vetëm themelues, duke u nënshkruar si më poshtë:

ORTAKU I VETËM THEMELUES I SHOQËRISË TREGTARE

"MONTIS Travel & Tours" SHPK

Entela SHEHAJ

Entela Shehaj
